



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE  
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

# VLERËSIMI I KAPACITETEVE DHE NEVOJAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

## Raport Vlerësimi

Tiranë, 2019

# Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Tiranë, Shqipëri 2019

## Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)

Website: [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

## Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

Email: [info@resourcecentre.al](mailto:info@resourcecentre.al)

Website: [www.resourcecentre.al](http://www.resourcecentre.al)

Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,  
Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1  
Kodi Postar 1010, Tirana, Albania  
Tel: +355 4 2254881

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as cilindo person që vepron në emër të tyre, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që përmban ai.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri falenderon të gjitha organizatat për bashkëpunimin dhe përfshirjen në realizimin e këtij studimi.

## Tabela e përmbajtjes

TREGUESI I GRAFIKËVE .....	4
SHKURTIME .....	5
HYRJE .....	6
GJETJET KRYESORE.....	8
I.    INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH OSHC-VE TË INTERVISTUARA.....	8
II.   ZHVILLIMI INSTITUCIONAL DHE QENDRUESHMËRIA ORGANIZATIVE .....	15
Politikat e procedurat e brendshme dhe dokumentet strategjikë.....	15
Sfida dhe nevoja në zhvillimin dhe qendrueshmërinë organizative të OSHC-ve.....	17
Kapacitetet e OSHC-ve dhe nevojat për trajnim.....	19
Nevoja të tjera të OSHC-ve për fuqizim kapacitetesh .....	23
Raportimi dhe transparenca e OSHC-ve.....	24
III.  MENAXHIMI DHE QENDRUESHMËRIA FINANCIARE .....	25
OSHC-të si ofrues të shërbimeve me pagesë dhe qendrueshmëria financiare.....	27
Burimet e financimit dhe aksesit i OSHC-ve.....	29
Nevojat e OSHC-ve për qendrueshmëri financiare .....	31
IV.  PJESËMARRJA NË NISMA ADVOKUESE .....	31
Nevojat e OSHC-ve për advokim efektiv .....	34
V.   INTEGRIMI EVROPIAN DHE ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË KËTË PROCES .....	35
VI.  RRJETËZIMET / KOALICIONET .....	38
VII. MARRËDHËNIA ME PUSHTETIN VENDOR E QENDROR .....	41
Nevojat e OSHC-ve për rritjen e pjesëmarrjes në proceset vendimarrëse dhe politikëbërëse....	42
VIII. MARRËDHËNIA ME MEDIAN .....	43
IX.  MARRËDHËNIA ME SEKTORIN PRIVAT .....	45
Nevojat për rritje të kapaciteteve për zhvillimin e bashkëpunimit me sektorin e biznesit .....	46
KONKLUSIONE.....	47
REFERENCA .....	52

## TREGUESI I GRAFIKËVE

Grafiku 1. Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve.....	8
Grafiku 2. Shpërndarja e OSHC-ve sipas vitit themelimit.....	9
Grafiku 3. Shpërndarja rajonale e OSHC-ve sipas viteve të themelimit.....	10
Grafiku 4. Shtrirja gjeografike e veprimtarisë së organizatave.....	11
Grafiku 5. Punësimi dhe vullnetarizmi .....	12
Grafiku 6. Raporti i punësimit burra dhe gra në sektor.....	13
Grafiku 7. Koha mesatare e aktivizimit të vullnetarëve në OSHC .....	14
Grafiku 8. Politikat dhe procedurat e brendshme në OSHC .....	16
Grafiku 9. Format e përdorura për rritjen e kapaciteteve të stafit.....	19
Grafiku 10. Tema trajnimi me interes të lartë për stafin drejtues të organizatës .....	21
Grafiku 11. Tema trajnimi me interes të lartë për stafin e organizatës .....	22
Grafiku 12. Fushat e trajnimit me interes për OSHC-të sipas vjetërsisë së OSHC-së.....	23
Grafiku 13. Publikimi i Raporteve Vjetore nga OSHC-të .....	25
Grafiku 14. Të ardhurat e OSHC-ve sipas kategorive të burimeve .....	26
Grafiku 15. Arsyet e OSHC-ve për mos angazhim në shërbime me pagesë.....	28
Grafiku 16. Keni plane për ofrimin e shërbimeve me pagesë në të ardhmen .....	29
Grafiku 17. Aksesit në burimet e financimit.....	30
Grafiku 18. Përfshirja në fushata Advokimi .....	32
Grafiku 19. Arsyet e OSHC-ve për mospërfshirje në fushata advokimi.....	33
Grafiku 20. Shtrirja gjeografike e fushatave advokuese .....	34
Grafiku 21. Roli i shoqërisë civile në procesin e integritimit .....	35
Grafiku 22. Niveli njohurive të OSHC-ve mbi procesin e integritimit dhe rolin e tyre në të .....	36
Grafiku 23. Kontributi i shoqërisë civile në procesin e integritimit sipas OSHC-ve .....	37
Grafiku 24. Niveli i njohjes së programeve të mbështetjes dhe financimit të BE-së nga OSHC-të .....	38
Grafiku 25. Shtrirja gjeografike e veprimtarisë së rrjeteve/koalicioneve të OSHC-ve.....	39
Grafiku 26. Sfidat e punës në rrjete/koalicione.....	40
Grafiku 27. Bashkëpunimi i OSHC-ve me pushtet vendor/qendror .....	41
Grafiku 28. Aksesit i OSHC-ve në media.....	43
Grafiku 29. Kanalet e komunikimit të OSHC-ve.....	44
Grafiku 30. Si njihet biznesi me OSHC-të dhe veprimtarinë e tyre.....	46

## SHKURTIME

AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BE	Bashkimi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Para-Aderimit
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
MM	Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë
NS	Ndërmarrje Sociale
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
PSh	Partnerët Shqipëri
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## HYRJE

Ky vlerësim u realizua nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, një platformë për shoqërinë civile në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve të saj, dialogut të politikave dhe përpjekjeve advokuese për një mjedis mundësues.

Qendra është një nismë e Partnerëve Shqipëri, finacuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA).

Qëllimi i vlerësimit është identifikimi i kapaciteteteve organizative të sektorit në shkallë kombëtare, i nevojave dhe sfidave në menaxhimin organizativ e bashkëpunimin ndërsektorial dhe përdorimi i këtij informacioni për të drejtuar hartimin e programeve për trajnim dhe asistencë teknike për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri do të ofrojë si pjesë e programit të saj të parë tre vjeçar në mbështetje të sektorit.

Duke konsideruar shtrirjen gjeografike të vlerësimit, përfaqësimin e OSHC-ve si dhe gamën e gjerë të çështjeve që përfshihen në të, gjetjet e vlerësimit mund t'u vinë në ndihmë dhe organizatave e institucionve të tjera që kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve të sektorit dhe mbështetjen e tij.

Raporti i vlerësimit ofron një panoramë analitike të zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile ndër vite, faktorëve të mundshëm ndikues si dhe tendencave në zhvillim në sektor.

Me qëllim pasqyrimin sa më të plotë të këndvështrimit dhe qëndrimit të OSHC-ve kundrejt proceseve dhe marrëdhënieve ndërsektoriale të një rëndësie të veçantë, raporti përfshin dhe sugjerime të OSHC-ve mbi përmirësimin e këtyre marrëdhënieve.

Qendra Kombëtare Burimore hartoi dhe zhvilloi një proces dy mujor përgjatë periudhës maj-qershor 2019, për vlerësimin e nevojave të OSHC-ve në nivel kombëtar.

Me qëllim mbledhjen e të dhënave sasiore nga një numër sa i madh organizatash, u hartua një pyetësor gjysëm i strukturuar i cili iu dërgua paraprakisht të gjitha organizatave pjesë e databazës së organizatave që Partnerët Shqipëri disponon. Që prej fillimit të veprimtarisë së saj, Partnerët Shqipëri ka krijuar adresarin e organizatave të shoqërisë civile bazuar mbi një vlerësim të gjerë të sektorit zhvilluar në vitin 2001. Ndër vite, si pjesë thelbësore e punës së saj me OSHC-të dhe institucione të tjera në vend, e në kuadër edhe të rolit që PSh ka patur si organizatë burimore dhe mbështetëse për zhvillimin e kapaciteteve dhe mjedisit mundësues të OSHC-ve, databaza është zhvilluar e pasuruar më tej me kontakte të përditësuara jo vetëm nga aktiviteti i PSh (trajnime, konferenca, takime me sektorin) por edhe nga lista të tjera të

institucioneve shtetërore e donatorëve në vend. 157 organizata në të dymbëdhjetë qarqet, iu përgjigjën pozitivisht ftesës për të qenë pjesë e studimit. Megjithëse numri i respondentëve nuk është shumë i madh, krahasuar me numrin e deklaruar të OSHC-ve, theksojmë që ky numër përbën pjesën më të madhe të organizatave aktive në vend.

Në vijim u kryen intervista ballë për ballë dhe me telefon kryesisht me nivelin e lartë drejtues (drejtorët ekzekutivë ose presidentët) e në mungesë të tyre me menaxherë programesh deleguar nga drejtuesi i organizatës.

Pyetëtori përmbante pyetje të hapura dhe të mbyllura që vlerësojnë kapacitetet e OSHC-ve, boshllëqet ekzistuese dhe nevojat për trajnim dhe asistencë në disa dimensione të zhvillimit të OSHC-ve dhe veprimtarisë së tyre si: (1) zhvillimi dhe qendrueshmëria organizative e OSHC-ve, (2) menaxhimi dhe qendrueshmëria financiare, (3) pjesëmarrja në nisma advokuese, (4) procesi i anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe roli i shoqërisë civile, (5) rrjetëzimet dhe koalicionet në sektor, (6) marrëdhënia me pushtetin vendor dhe atë qendror, (7) marrëdhënia me median dhe (8) marrëdhënia me sektorin privat.

### Kufizimet e vlerësimit

Gjatë zhvillimit të studimit, si në mbledhjen e të dhënave dhe në shkrimin e raportit të vlerësimit kufizimet kryesore ishin: (1) numri i organizatave që u intervistuan i cili megjithëse në dukje është i ulët në krahasim me numrin e organizatave që rezultojnë të regjistruara (2000+ OSHC të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve), është një kampion studimi përfaqësues sepse përfshin pjesën më të madhe të organizatave aktive në vend; (2) të dhënat e vetëraportuara nga OSHC-të. Vlerësimi i kapacitetit u bazua në informacionet e marra përmes intervistave me përfaqësues të OSHC-ve dhe vet-deklarimit të tyre për të gjitha çështjet. Në këto kushte, të dhënat e vetëraportuara kufizohen nga fakti që ato mund të jenë subjektive dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur.

## GJETJET KRYESORE


### I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH OSHC-VE TË INTERVISTUARA

Numri i organizatave të intervistuar në kuadër të këtij vlerësimi është 157 organizata, me një shtrirje gjeografike në veri, qendër dhe jug të Shqipërisë.

Ndër organizatat e intervistuar 58% e tyre janë të regjistruara dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre si Shoqata, 31% si Qendra dhe 11% e tyre si Fondacione.

Sektorët e veprimtarisë së organizatave pjesëmarrëse në këtë vlerësim janë të larmishëm. Pjesa më e madhe e organizatave kryejnë veprimtarinë e tyre dhe kontribuojnë në më shumë se sa një sektor. Në Grafikon 1 janë paraqitur fushat e veprimtarisë së organizatave pjesë e këtij vlerësimi.


Grafiku 1. Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve





Nga të dhënat e grumbulluara, rezulton se prirja për rritje e sektorit të OSHC-ve, për nga numri i organizatave të themeluara, në intervale kohore 5-vjeçare, është e qëndrueshme me mesatarisht 17% rritje për interval kohor. Nëse krahasojmë rritjen për çdo interval vitesh, janë dy momente ku rritja e sektorit është më e dukshme krahasuar me 5-vjeçarët e tjerë, më konkretisht përgjatë intervalit të viteve 1996-2000 me 8% rritje dhe viteve 2011-2015 me 12% (Grafiku 2).

Grafiku 2. Shpërndarja e OSHC-ve sipas vitit themelimit



Periodha e viteve 1996-2000 përkon me një sërë ngjarjesh politiko-ekonomike-shoqërore me ndikim të gjerë në vend dhe rajon. Rënia e skemave piramidale më 1997 solli një kolaps të shërbimeve sociale dhe thellim të krizës ekonomike-sociale. Më tej, lufta e Kosovës dhe zhvendosja e refugjatëve kosovarë në Shqipëri krijoi një situatë emergjente për ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve sociale por jo vetëm. Këto zhvillime çuan në krijimin dhe zhvillimin e një komuniteti të gjerë organizatash jofitimprurëse në fusha të larmishme. (HRW, 1999).<sup>1</sup>


<sup>1</sup> Humans Rights Watch Report 1999 <https://www.hrw.org/legacy/worldreport99/>

Në dhjetëvjeçarin e fundit vërehet një rritje më e madhe e OSHC-ve në sektorët e zhvillimit ekonomik, rinisë dhe fëmijëve, qeverisjes së mirë, edukimit, dhe integritimit Evropian.

Megjithatë pavarësisht prirjeve në rritje të sektorit, mungesa e të dhënave<sup>2</sup> të unifikuara publike mbi OSHC-të vazhdon të verë në pikëpyetje madhësinë e sektorit.

Përqëndrimi i themelimit të organizatave të reja pavarësisht fokusit të tyre të punës, vazhdon të mbetet në qendrat kryesore urbane rajonale. Rajoni gjeografik qendror (Grafiku 3) mbetet rajoni me përqëndrimin dhe rritjen më të madhe të organizatave krahasur me rajonin verior dhe atë jugor. Ky trend ndikohet më së shumti nga numri i organizatave të themeluara në qytetin e Tiranës, ku dhe përqëndrimi i organizatave është më i madh (39% e organizatave). I njëjti fenomen vërehet dhe në dy rajonet e tjera ku rritja më së shumti ndikohet nga përqëndrimi i organizatave në qytetin e Shkodrës me 13% të të anketuarve për rajonin verior dhe në qytetin e Vlorës me 16% për rajonin jugor.

Grafiku 3. Shpërndarja rajonale e OSHC-ve sipas viteve të themelimit




<sup>2</sup> Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë, 2018 [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Matrica\\_monitorimit\\_Raporti\\_per\\_shqiperine\\_2018.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Matrica_monitorimit_Raporti_per_shqiperine_2018.pdf)

Prirja e përqëndrimit të OSHC-ve kryesisht në kryeqytet apo qytet kryesore të rajoneve është një prirje e qëndrueshme në kohë. Kombinimi i zhvillimit ekonomik dhe mundësive për arsimim më të mirë, e ka kthyer Tiranën por dhe qendrat e tjera rajonale në qytete kryesore të migrimit të popullsisë<sup>3</sup>. Rritja e popullsisë me ritme të larta, në kundërshti me ritmin e ngadaltë të zhvillimit të shërbimeve sociale nga institucionet vendore, mund të shpjegojë nevojën e rritjes së sektorit të shoqërisë civile si një përgjigje alternative kundrejt nevojave sociale të lindura.

Pjesa më e madhe e organizatave, 61% e tyre e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel kombëtar, dhe 42% në nivel lokal. Sikurse paraqitet në Grafikon 4, prezenca e veprimtarisë së organizatave shqiptare në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Evropë mbetet relativisht në nivele të ulta respektivisht në masën 31% dhe 5%.

Grafiku 4. Shtrirja gjeografike e veprimtarisë së organizatave




Sipas të dhënave të vlerësimit në lidhje me punonjësit, ekspertët dhe vullnetarët e angazhuar në organizata, 20% e OSHC-ve deklarojnë se për arsye të mungesës së fondeve nuk kanë patur fare punonjës me kohë të plotë të punësuar përgjatë vitit 2018, ndërkohë 3% e tyre nuk kanë

<sup>3</sup> Migracioni në Shqipëri, Instat 2014 [http://www.instat.gov.al/media/3078/migracioni\\_ne\\_shqiperi.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3078/migracioni_ne_shqiperi.pdf)

patur asnjë të punësuar as me kohë të plotë as të pjesshme, por kanë punuar vetëm me vullnetarë.

Një pjesë e madhe e organizatave deklarojnë që kanë staf të punësuar me kohë të pjesshme (76%) si dhe vullnetarë të angazhuar (85%). Vitet e fundit është rritur ndjeshëm dhe kontraktimi i ekspertëve afatshkurtër për nevoja të organizatave apo të projekteve të cilat ato zbatojnë. Kështu, 68% e organizatave deklarojnë që kanë punuar me ekspertë të jashtëm vitin e fundit (Grafiku 5).


Grafiku 5. Punësimi dhe vullnetarizmi



Mesatarja e punësimit të stafit për organizatë rezulton të jetë 6 të punësuar me kohë të plotë dhe 4 me kohë të pjesëshme. Ky rezultat ndikohet veçanërisht nga disa organizata kryesisht në Tiranë që kanë numër të madh punonjësish. Respektivisht mesatarja e punësimit varion nga 9 të punësuar për organizatë në Tiranë në 4 të punësuar për organizatë në qytete të tjera. Në Tiranë, punësimi me kohë të plotë dhe të pjesshme rezulton të jetë respektivisht mesatarisht 9 dhe 3 të punësuar për organizatë. Në organizatat jashtë Tiranës, raporti i punësimit të stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme është thujtë i njëjtë (mesatarisht 4 të punësuar). Këto të dhëna tregojnë për një sektor të organizatave të shoqërisë civile financiarisht më të qendrueshëm në Tiranë krahasuar me pjesën tjetër të vendit.

Raporti i punësimit burra-gra në organizatat e shoqërisë civile që prej fillesave të veprimtarisë së sektorit është dominuar nga gratë dhe vajzat. Edhe përgjatë vitit 2018, sipas të dhënave të vlerësimit vazhdon të dominohet ndjeshëm nga gratë dhe vajzat (Grafiku 6), kjo në ndryshim me trendin e punësimit në rang vendi ku sipas INSTAT punësimi i burrave dominon me 66.7%<sup>4</sup> të të punësuarve në tregun e punës për vitin 2018.

Grafiku 6. Raporti i punësimit burra dhe gra në sektor



Një pjesë shumë e rëndësishme e burimeve njerëzore të OSHC-ve janë vullnetarët. Sipas të dhënave të grumbulluara, numri i vullnetarëve të angazhuar në organizata mesatarisht varion nga 4-12 vullnetarë.

Nëse analizojmë shpërndarjen e vullnetarëve sipas llojit të veprimtarisë së organizatave, rezulton se vullnetarët angazhohen në të gjitha organizatat, pavarësisht fushës së veprimtarisë së tyre, gjithsesi dallon angazhimi i tyre më i lartë pranë organizatave që punojnë me të rinjtë dhe fëmijët (58% të rasteve) dhe fushën e të drejtave të njeriut (46% të rasteve). Fusha e veprimtarisë me aktivizimin më të ulët të vullnetarëve rezulton të jetë ajo e marrëdhënieve

<sup>4</sup> Burrat dhe gratë në Shqipëri 2019, Instat <http://www.instat.gov.al/media/5956/burra-dhe-grat%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2019.pdf>

ndërkombëtare dhe integritit evropian, fusha e shëndetit dhe shërbimet ndaj personave me nevoja të veçanta.

Koha e aktivizimit të vullnetarëve kryesisht varion nga 1-3 muaj ndjekur nga 6 muaj deri në një vit (Grafiku 7).

Grafiku 7. Koha mesatare e aktivizimit të vullnetarëve në OSHC



Faktorët kryesorë që ndikojnë në aktivizimin dhe kohëzgjatjen e periudhës së vullnetarizimit janë kryesisht dëshira e vullnetarëve për të kontribuar në misionin dhe kauzën e punës së organizatës; kohëzgjatja e projekteve dhe aktiviteteve ku vullnetarët angazhohen; rritja e aftësive personale dhe profesionale nëpërmjet ndërveprimit, pjesëmarrjes në trajnime dhe në programe shkëmbimi. Një pjesë e vogël e organizatave (7%) deklarojnë që angazhimi i vullnetarëve ka qenë në kuadër të praktikave mësimore universitare. Në vitet e kaluara, ky numër ka qenë shumë më i lartë dhe organizatat deklarojnë që kanë patur shumë më tepër vullnetarë të angazhuar në kuadër të praktikave universitare. Bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit parauniversitar shihet si i vështirë dhe i ngarkuar me procedura burokratike dhe penguese që frenojnë këtë bashkëpunim dhe angazhimin e të rinjve në organizatat e shoqërisë civile.

Pavarësisht kërkesave dhe dëshirës për të qenë vullnetarë, sipas Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2018<sup>5</sup> (MM), pothuaj tre vjet pas miratimit të Ligjit 45/2016 “Mbi Vullnetarizmin”, aktet nënligjore që priten të adresojnë regjistrin e vullnetarëve, krijimin e skemave të financimit publik, krijimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi aktivitetin vullnetar në vend dhe kodi etik për vullnetarizmin nuk janë hartuar ende. Si rezultat, OSHC-të ende përballen me vështirësi dhe pasiguri në përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të gjobave.

## II. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL DHE QENDRUESHMËRIA ORGANIZATIVE


### Politikat e procedurat e brendshme dhe dokumentet strategjike

Sipas të dhënave të vlerësimit, 65% e OSHC-ve kanë politika dhe procedura të brendshme organizative, miratuar nga organet vendimmarrëse, të cilat rregullojnë veprimtarinë e organizatës. Pjesa më e madhe e këtyre procedurave janë zhvilluar vitet e fundit, edhe si orjentim dhe kërkesë e donatorëve apo organizatave që menaxhojnë projekte të donatorëve me skema të nën-grantimit. Në disa raste, organizatat lokale edhe janë mbështetur prej tyre për ti hartuar dhe zhvilluar më tej këto politika dhe procedura të brendshme, me qëllim rritjen e standardeve të OSHC-ve, të performancës së veprimtarisë së tyre si dhe të qendrueshmërisë së sektorit. Në Grafikon 8 paraqiten të dhëna lidhur me një sërë procedurash të cilat OSHC-të deklarojnë që kanë. Se si janë hartuar këto procedura, çfarë përmbajnë dhe sa njihen e zbatohen nga drejtuesit, punonjësit dhe vullnetarët e organizatave, është një informacion që nuk ishte subjekt i këtij vlerësimi dhe nuk mund të verifikohet.

---

<sup>5</sup> Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2018, Partnerët Shqipëri [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Matrica\\_monitorimit\\_Raporti\\_per\\_shqiperine\\_2018.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Matrica_monitorimit_Raporti_per_shqiperine_2018.pdf)

Grafiku 8. Politikat dhe procedurat e brendshme në OSHC



Planifikimi Strategjik është një faktor kyç për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile dhe qendrueshmërinë e tyre. Ai është shumë i rëndësishëm por në të njëjtën kohë mund të jetë diçka shumë komplekse dhe e vështirë për t'u realizuar veçanërisht nga organizatat e vogla e pa shumë kapacitete. Sipas të dhënave të vlerësimit 58% e organizatave kanë një plan strategjik. Pjesa tjetër e OSHC-ve shprehin qartë nevojën për udhëzim dhe mbështetje për hartimin e një plani të tillë. Ndërkohë duhet theksuar se kjo nevojë deklarohet dhe nga OSHC që e kanë planin strategjik, duke qenë se është një dokument bazë për zhvillimin e organizatës dhe nevojitet të rishikohet dhe zhvillohet periodikisht.

Të paturit një plan strategjik sipas vlerësimit rezulton që nuk është e lidhur me vjetërsinë e organizatës. Mungesa e tij deklarohet si nga organizata të themeluara që herët e me veprimtari të gjatë në sektor, ashtu dhe nga organizata të reja.

Zhvillimi i objektivave strategjik në 93% të rasteve rezulton të jetë i bazuar në misionin dhe statutin e organizatës, ndjekur nga zhvillimi bazuar në nevojat e përfituesve me 73% të rasteve dhe nevojat e vetë organizatës në 61% të rasteve. Këto të dhëna, tregojnë për një ndryshim të orientimit të OSHC-ve në hartimin e planit strategjik. Nëse i referohemi Vlerësimit të vitit 2011 mbi nevojat e sektorit të kryer nga Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO), organizatat praktikojnë të ashtëquajturin “mission creep” që njihet si praktika e



largimit nga/ose braktisjes së misionit, vizionit dhe pikave të forta organizative në favor të ndjekjes së mundësive të financimit. Ndërkohë, të dhënat e vlerësimit tregojnë që vetëm 51% e organizatave bazohen në politika dhe programe të donatorëve kryesorë për hartimin e objektivave strategjik.

Sa i përket procesit të hartimit të planit strategjik, 80% e organizatave deklarojnë se e kanë hartuar planin strategjik përmes një procesi të brendshëm me përfshirjen e stafit, bordit të organizatës dhe përfituesve të saj. Kontraktimi i ekspertëve të jashtëm, kryesisht vendas por edhe të huaj në pak raste për lehtësimin e këtij procesi, është një nga mënyrat e përdorura në një pjesë të konsiderueshme të organizatave (36%), ndërkohë 28% e organizatave deklarojnë që janë mbështetur me ekspertë lehtësues nga donatori i tyre kryesor për këtë proces.

### Sfida dhe nevoja në zhvillimin dhe qendrueshmërinë organizative të OSHC-ve

Pavarësisht zhvillimeve, sektori i shoqërisë civile duke qenë një sektor dinamik, ndeshet me një seri sfidash të njëpasnjëshme duke zhvilluar nevoja të vazhdueshme.

Çështjet më sfiduese për organizatat dhe veprimtarinë e tyre, sipas deklaramit të OSHC-ve janë: (1) Mungesa e fondeve (2) Kuadri ligjor dhe fiskal për OSHC-të (3) Mungesa e bashkëpunimit me pushtetin vendor e qendror dhe mospërfshirja në politikëbërje dhe (4) Mungesa e mekanizmave/pamundësia për të marrë pjesë në tendera për ofrimin e shërbimeve publike.

Këto katër nevoja në një këndvështrim analitik mund të konsiderohen ngushtësisht të lidhura dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë faktorë ndikimi kundrejt përpjekjeve të OSHC-ve për ti adresuar ato.

Mungesa e fondeve dhe vështirësia për marrjen e tyre, konsiderohet si sfida më e madhe që organizatat deklarojnë, çka ndikon drejtpërdrejtë në qendrueshmërinë e tyre financiare. Kjo sfidë, bëhet edhe më e vështirë kur “ushqehet” nga mungesa dhe/ose kuadri ligjor fiskal problematik dhe jo mundësues. Një shembull referimi për këtë është pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së) nga OSHC-të për projektet e financuara nëpërmjet fondeve IPA të Bashkimit Evropian (BE). Edhe pse rimbursimi i TVSH-së ndaj këtyre fondeve është një detyrim i qeverisë në kuadër të zbatimit të marrëveshjes me BE, ende nuk ka një konfirmim zyrtar<sup>6</sup> mbi rimbursimin e TVSH-së për projektet e skemës IPA të zbatuara nga OSHC-të.

---

<sup>6</sup> Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2018, Partnerët Shqipëri

Trajtimi fiskal i OSHC-ve mbetet problematik<sup>7</sup> dhe paraqet një pengesë të madhe për veprimtarinë, zhvillimin dhe qendrueshmërinë e tyre.

Nga ana tjetër aksesimi në fondet publike si një mundësi financimi për OSHC-të konsiderohet sfidues, si pasojë e mungesës së diferencuar të sektorit jofitimprurës. Kështu, gjatë vitit 2018, nuk është ndërmarrë apo diskutuar asnjë<sup>8</sup> nismë ligjore mbi ligjin për prokurimet publike që do të lehtësonte pjesëmarrjen e OSHC-ve në proceset e tenderimit publik. Kuadri ligjor dhe rregullator paraqet shumë sfida dhe çështje për t'u adresuar në mënyrë që të krijohet një mjedis mundësues për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale me fonde publike.

Pavarësisht hapësirave ligjore ekzistuese, shfrytëzimi i aseteve shtetërore vendore apo aksesimi në fonde për ofruesit e shërbimeve sociale dhe ndarja e kostove të shërbimit me institucionet qendrore dhe lokale rezulton të jetë tejet e vështirë, thuajse e pamundur në kontekstin lokal.

Ligji “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” u miratua në 2016 dhe një numër aktesh nënligjore janë miratuar gjatë një periudhe tre vjeçare. Megjithatë paketa Ligjore nuk është zbatuar ende për shkak të paqartësive që mbart. Nisur nga impakti social që ka puna e OSHC-ve ofruese të shërbimeve sociale si dhe natyra e ndryshme nga ajo e sektorit të biznesit, krijimi i mekanizmave dhe lehtësirave ligjore është një nevojë imediate për të mundësuar një mjedis sa më të përshtatshëm për organizatat për të siguruar fonde alternative dhe praktikimin e ekspertizës së tyre si ofrues shërbimesh.

Promovimi dhe rritja e vizibilitetit mbi shërbimet e ofruara jo vetëm në kuadër të ngritjes së fondeve nga donatorë apo biznese por dhe për të qenë sa më pranë përfituesve e për ti informuar e ndërgjegjësuar ata, deklarohet si një tjetër nevojë ndër OSHC-të pjesë e këtij vlerësimi.

Mungesa e bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe mospërfshirja e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse e politikëbërëse mbetet ende një problematikë konstante e sektorit të shoqërisë civile, pavarësisht përmirësimit në vitet e fundit të kuadrit ligjor mbi informimin, konsultimin dhe angazhimin publik. Ky tregues mbështetet dhe nga gjetjet e MM për vitin 2018 ku edhe pse miratimi i ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” konsiderohet si ligj përparimtar, zbatimi i tij, pothuajse në të gjitha aspektet është i dobët<sup>9</sup>. Pavarësisht përpjekjeve për krijimin e një mjedisi ligjor rregullator sa më mundësues për sektorin e shoqërisë civile, moszbatimi i tij pengon zhvillimin e qendrueshëm të OSHC-ve.

---

<sup>7</sup> idem

<sup>8</sup> idem


<sup>9</sup> idem

## Kapacitetet e OSHC-ve dhe nevojat për trajnim

Ngritja e kapaciteteve të stafit të organizatës, sipas të dhënave të vlerësimit, konsiderohet si një prej faktorëve kryesorë që ndikon në qëndrueshmërinë e OSHC-ve. Pavarësisht sfidave dhe vështirësive me të cilat ndeshen gjatë veprimtarisë së tyre, 94% e organizatave të intervistuar deklarojnë që krijojnë hapësira për rritjen e kapaciteteve të stafit. Më së shumti kjo mundësohet përmes pjesëmarrjes në trajnime të organizuara nga OSHC të tjera ofruese të këtij shërbimi për çështje lidhur me zhvillimin organizativ si dhe çështje të tjera specifike sipas fokusit të punës së OSHC-ve. (Grafiku 9).

Përdorimi i metodave të reja të ngritjes së kapaciteteve si ajo e e-learning edhe pse njihen si metoda efiçente në kohë dhe në kosto, mbetet në nivele të ulta me vetëm 16% të rasteve.

Grafiku 9. Format e përdorura për rritjen e kapaciteteve të stafit



Të dhënat e vlerësimit në lidhje me nevojat dhe interesin mbi tematikën e programeve të trajnimit, vazhdojnë të reflektojnë problematikat e përmendura sa më sipër.

Kështu sikurse paraqitet në Grafikon 10, interesi më i lartë në ngritjen e kapaciteteve të stafit drejtues të OSHC-ve është ndaj programeve të trajnimit për ngritjen e fondeve dhe gjenerimin e të ardhurave, pasuar nga planifikimi strategjik, sipërmarrja sociale, ndërtimi i rrjeteve / koalicioneve dhe legjislacioni tatimor e raportimi financiar.

Qendrueshmëria financiare mbetet një nga çështjet më sfiduese për organizatat e shoqërisë civile. OSHC-të kryesisht mbështeten në grante, por bazuar në një studim të fundit, 93%<sup>10</sup> e përfaqësuesve të OSHC-ve shprehen se marrja e granteve është bërë shumë e vështirë në 18 muajt e fundit. Ja pse organizatat janë duke i drejtuar përpjekjet e tyre në këtë kuadër drejt ngritjes së fondeve dhe gjetjes së burimeve të tjera alternative të ardhurash për sigurimin e misionit të tyre social<sup>11</sup>. Një nga format për gjenerimin e fondeve është dhe sipërmarrja sociale për të cilën në dekadën e fundit ka një përpjekje në rritje të aktorëve për të rregulluar këtë fushë duke përfshirë edhe nivelet politikëbërëse, të cilët kanë kuptuar potencialin e madh të sipërmarrjes sociale. Gjithmonë e më shumë sipërmarrja sociale po konsiderohet<sup>12</sup> si një mjet i rëndësishëm drejt një shoqërie të drejtë, një kontributor në zhvillimin social dhe ekonomik.

Megjithëse nga të dhënat e vlerësimit rezulton se një pjesë e mirë e organizatave kanë një plan strategjik, planifikimi strategjik ende identifikohet si një nevojë për trajnim për stafin drejtues. Nevoja për rritjen dhe përmirësimin e njohurive në aspektin e planifikimit strategjik të një organizate mund të lidhet me nevojat e mësipërme dhe përpjekjet për të eksploruar dhe punuar në forma të reja dhe të ndryshme nga forma tradicionale e OSHC-ve siç konsiderohet financimi përmes granteve.


---

<sup>10</sup> Platformat crowdfunding – Një burim alternativ i financimit, Partnerët Shqipëri, 2019 <http://partnersalbania.org/publication/platformat-croëdfunding-nje-burim-alternativ-i-financimit/>

<sup>11</sup> idem

<sup>12</sup> Analizë e Kuadrit Ligjor mbi Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri, Partnerët Shqipëri, 2019: [http://partnersalbania.org/ëp-content/uploads/2019/06/Analiz%C3%AB\\_e\\_Kuadrit\\_Ligjor\\_mbi\\_Nd%C3%ABrmarrjet\\_Sociale\\_n%C3%AB\\_Shqip%C3%ABri.pdf](http://partnersalbania.org/ëp-content/uploads/2019/06/Analiz%C3%AB_e_Kuadrit_Ligjor_mbi_Nd%C3%ABrmarrjet_Sociale_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri.pdf)


Grafiku 10. Tema trajnimi me interes të lartë për stafin drejtues të organizatës



Situata paraqitet thujtë e njëjtë edhe për temat e trajnimit të identifikuar si të nevojshme për rritjen e kapaciteteve të stafit të OSHC-ve. Interesi më i madh rezultojnë të jetë për rritjen e njohurive dhe aftësive të stafit mbi programet dhe mundësitë e financimit nga BE, shkrimi i projekt propozimeve sipas kërkesave dhe formateve të Bashkimit Evropian si dhe zhvillimi i projekt propozimeve në përgjithësi (Grafiku 11). Duke marrë në konsideratë nga njëra anë faktin se gjithnjë e më shumë Bashkimi Evropian po rrit prezencën e tij me programe të financimit për OSHC-të shqiptare në nivel lokal, rajonal dhe Evropian, e nga ana tjetër kompleksitetin e thirrjeve dhe kapacitetet që nevojiten për t’ju përgjigjur në kohë e me cilësi, nevoja e OSHC-ve për fuqizim të kapaciteteve në këtë drejtim mbetet e madhe.


Të tjera tema trajnimi me interes të lartë për stafin e OSHC-ve janë dhe ngritja e fondeve e gjenerimi i të ardhurave si dhe menaxhimi i projekteve.

Grafiku 11. Tema trajnimi me interes të lartë për stafin e organizatës



Të dhënat e vlerësimit tregojnë se pavarësisht vjetërsisë së organizatës, nevoja dhe interesi për tematikën e trajnimeve është në të njëjtat nivele, si në organizatat e reja ashtu dhe në organizatat me shumë vite eksperiencë. Kështu për shembull ngritja e fondeve dhe gjenerimi i të ardhurave, legjislacioni tatimor, menaxhimi dhe lidhësitë e të tjera tematika, kanë pak a shumë të njëjtin nivel interesi si nga organizatat e reja dhe nga ato me eksperiencë.

Grafiku 12. Fushat e trajnimit me interes për OSHC-të sipas vjetërsisë së OSHC-së



### Nevoja të tjera të OSHC-ve për fuqizim kapacitetesh

Krahas trajnimit, i cili mbetet një nga mjetet kryesore për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, OSHC-të pjesë e këtij vlerësimi kanë identifikuar dhe një seri nevojash të tjera të cilat ndikojnë në zhvillimin organizativ si mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara (veçanërisht jashtë Tiranës dhe qyteteve të tjera mëdha në vend); mungesa e mjediseve ku OSHC-të të kryejnë veprimtarinë e tyre (infrastrukturë zyre dhe mjete logjistike); mungesa e lehtësirave fiskale për sektorin; mungesa e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet në nivel vendor e qendror; mungesa e njohjes së punës dhe kontributit të OSHC-ve; vështirësitë në mobilizimin e komunitetit dhe vullnetarëve, etj.

Mungesa e partneritet dhe rrjetëzimit brenda sektorit midis organizatave në vend dhe jashtë tij, rezulton si një tjetër nevojë në sektor. OSHC-të deklarojnë që partneriteti kryesisht shihet në kuadër të aplikimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkëta brenda organizatave me mision e fushë të ngjashme veprimi, si dhe për përfitimin e njohurive dhe eksperiencave nga organizata

më të zhvilluara, me më shumë kapacitete dhe të përqëndruara kryesisht në zonat urbane (veçanërisht në Tiranë). Mungesa e aktiviteteve dhe mbështetjes për rrjetëzime e partneritete; numri i limituar i programeve të shkëmbimit të eksperiencave, modeleve e praktikave të mira; i vizitave studimore që mundësojnë avancimin e mëtejshëm të OSHC-ve etj. janë disa nga nevojat e identifikuara nga OSHC-të. Aksesit dhe pjesëmarrja e ulët në rrjete rajonale dhe Evropiane është një nevojë që mbetet po ashtu për tu adresuar, me qëllim fuqizimin institucional, rritjen e vizibilitetit dhe marrëdhënies me publikun dhe aktorë të tjerë, si dhe përthithjen e fondeve.


### Raportimi dhe transparenca e OSHC-ve

Transparenca, konsiderohet si guri i themelit në ndërtimin e besimit dhe imazhit të një institucioni. Si e tillë, sa më transparente të jetë një organizatë jo-fitimprurëse mbi veprimtarinë dhe aktivitetet e saj, aq më shumë besim do të mund të krijojë ndaj bashkëpunëtorëve, grupeve të interesit, donatorëve, institucioneve qeveritare dhe publikut të gjerë.

79.5% e organizatave të intervistuar shprehen se hartojnë raporte vjetore mbi veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre. 65% e organizatave të përfshira në vlerësim, kanë si pjesë të raportit të tyre të dhëna mbi aktivitetin e tyre financiar. Por situata ndryshon përse i përket publikimit dhe ndarjes së raporteve me publikun apo aktorë të tjerë. Vetëm 58% e organizatave i publikojnë dhe i ndajnë raportet vjetore nëpërmjet kanaleve të tyre të komunikimit brenda sektorit, grupeve të interesit dhe më gjerë, ndërkohë që 20% e organizatave rezultojnë ti ndajnë raportet dhe të dhënat mbi aktivitetin vetëm me donatorin, bordin drejtues dhe partnerë të tyre (Grafiku 13).



Grafiku 13. Publikimi i Raporteve Vjetore nga OSHC-të



Transparenca në sektor mbetet një çështje për të cilën nevojitet të punohet nga i gjithë sektori me qëllim përmirësimin e mëtejshëm.


### III. MENAXHIMI DHE QENDRUESHMËRIA FINANCIARE

Për efekt të vlerësimit kapaciteteve dhe të nevojave të sektorit në menaxhimin dhe qendrueshmërinë financiare si dhe të krijimit të një panorame sa më të qartë në këtë drejtim, OSHC-të e përfshira në vlerësim u pyetën për një seri çështjesh lidhur me burimet e financimit në përgjithësi e më specifikisht për vitin e fundit fiskal (vitin 2018) aksesin në këto burime, vështirësitë dhe sfidat etj.

Sikurse paraqitet në Grafikon 14, burimi kryesor i të ardhurave për OSHC-të vijojnë të mbeten të ardhurat nga grantet. Thuajse gjysma e OSHC-ve të intervistuar deklarojnë se ndër burimet e financimit për vitin 2018 kanë qenë grantet/nëngrantet e dhëna nga organizata jo-fitimprurëse vendase ose ndërkombëtare në Shqipëri. Vitet e fundit, disa nga donatorët më të mëdhenj në vend si Bashkimi Evropian, Qeveria Zvicerane përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) etj. po zbatojnë gjerësisht skemat e nën-grantimit si pjesë e projekteve të tyre, duke synuar arritjen dhe mbështetjen në masë sa më të gjerë të OSHC-ve lokale.

Një pjesë e organizatave (18%) nuk kanë dhënë informacion në lidhje me burimet e financimit dhe shpërndarjen e të ardhurave sipas tyre.

Grafiku 14. Të ardhurat e OSHC-ve sipas kategorive të burimeve



Ndër donatorët dhe programet kryesore të financimit të përmendur nga të anketuarit janë: Bashkimi Evropian me programet e Instrumentit të Para-Aderimit (IPA), Programet Evropiane si dhe Programin Rajonal për Demokraci Lokale (ReL0aD); Ambasada Zvicerane në Shqipëri dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC); Ambasada e Shteteve të Bashkuara; Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta; Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP); UNFPA; Programi SCPA "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" i Qeverisë Suedeze nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA); Olof Palme International Center; GIZ; Banka Botërore; Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA); Bread for the World; Canadian Fund for Local Initiative; International Orthodox Christian Charities dhe Global Giving etj. Gjithashtu si burim financimi nëpërmjet programeve të grant-dhënies listohen dhe organizata vendase si Lëviz Albania, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Partnerët Shqipëri, Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC), Save the Children, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Terre des Homes, Dorcas Aid Albania.

Ndërsa ndër institucionet shtetërore nga të cilat kanë përfituar fonde nisur nga të dhënat e marra gjatë këtij anketimi në nivel institucionesh qendrore përmendet Ministria e Kulturës ndërsa në nivel vendor Bashkia e Tiranës, Bashkia e Korçës dhe Bashkia e Librazhdit.

Të ardhurat nga fondet e pushtetit vendor janë vetëm në masën 12% ndërkohë ato nga pushteti qendror janë në nivele akoma më të ulta krahasuar me burimet e tjera të financimit, vetëm 10%. Sipas Matricës së Monitorimit për vitin 2018, të dhënat mbi financimin publik për OSHC-të nuk janë publike dhe nuk janë të lehta për t'u aksesuar. Transparenca e shpërndarjes së fondeve publike është e ulët dhe mbetet një çështje shqetësuese për sektorin. Pavarësisht faktit që institucionet publike kanë rregulla dhe procedura të mirëpërcaktuara mbi të, informacioni i bërë publik është jo i plotë dhe jo në përputhje me standardin e përcaktuar.

### OSHC-të si ofrues të shërbimeve me pagesë dhe qendrueshmëria financiare

Ofrimi i shërbimeve me pagesë nga OSHC-të për palë të treta vitet e fundit po përdoret gjithnjë e më shumë nga sektori i shoqërisë civile si një nga format për ngritjen dhe gjenerimin e fondeve. Sipas të dhënave të vlerësimit vetëm 32% e të intervistuarve të pyetur nëse zhvillojnë aktivitete për gjenerimin e të ardhurave apo shërbime me pagesë pohojnë se kanë eksperiencë të tilla. Ndër shërbimet e ofruara përmenden kurse trajnimi dhe ofrimi i ekspertizës brenda sektorit por dhe jashtë tij, prodhime artizanale, shërbime bar kafe dhe catering, guida turistike, shërbime mjekësore dhe shërbime sociale. Një tjetër formë gjenerimi të ardhurash në OSHC-të pjesë e këtij vlerësimi është dhënia me qira e mjediseve të organizatës për palë të treta si dhe ngritja e sipërmarrjeve sociale.


Shpërndarja gjeografike e organizatave që ofrojnë këto shërbime shtrihet në të tre rajonet por përqëndrimi më i madh mbetet në qytetin e Tiranës (40% të rasteve) pasuar me qytetin e Shkodrës (21% të rasteve). Të dhënat edhe një herë mbështesin gjetjet e studimeve të mëparshme mbi iniciativat e OSHC-ve në aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave ku ky model<sup>13</sup> konsiderohet si i paeksploruara nga qytetet e tjera të vendit.

Të pyetur mbi arsyet e mos angazhimit në praktikë të shërbimeve me pagesë, OSHC-të që nuk kanë patur eksperiencë të tilla, në një masë të konsiderueshme deklarojnë që e konsiderojnë procesin si të vështirë dhe sfidues (27%) si dhe që u mungojnë njohuritë dhe kapacitetet e duhura për të zhvilluar dhe menaxhuar një aktivitet të tillë (Grafiku 15).

---

<sup>13</sup> Gatishmëria e OSHC-ve për Përfshirjen në Aktivitete që Gjenerojnë të Ardhura [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/09/Gatishmeria\\_OSHC-ve\\_per\\_Perfshirje\\_ne\\_Aktivitete\\_qe\\_Gjenerojne\\_te\\_Ardhura.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/09/Gatishmeria_OSHC-ve_per_Perfshirje_ne_Aktivitete_qe_Gjenerojne_te_Ardhura.pdf)


Grafiku 15. Arsyet e OSHC-ve për mos angazhim në shërbime me pagesë



Përfshirja në aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave dhe ofrimi i shërbimeve me pagesë, duke u konsideruar shpesh jo në përputhje me “veprimtarinë jofitimprurëse” të OSHC-ve, nuk kuptohet drejtë e akoma më tej paragjykohet e gjykohet. Studimi i zhvilluar nga Partnerët Shqipëri “Gatishmëria e OSHC-ve për Përfshirjen në Aktivitete që Gjenerojnë të Ardhura” (2018) liston një tërësi sfidash të hasuara nga OSHC-të ofruese të shërbimeve me pagesë si: mungesa e mbështetjes institucionale për grante dhe/ ose kapitalit fillestar për të investuar në shërbime dhe produkte cilësore dhe aftësinë për t'i tregtuar ato në mënyrë profesionale; mungesa e përvojës sipërmarrëse që mund të çojë në "humbjen e parave për gjëra / hapa të panevojshëm"; mungesa e njohurive në lidhje me politikat fiskale dhe regjimet tatimore për sektorin e fitimeve. Studimi identifikon nevojën për ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve në këtë fushë dhe pajisjen e tyre me aftësi të duhura këtë sipërmarrje.

Të pyetur nëse planifikojnë të përfshihen në ofrimin e shërbimeve të reja me pagesë, 43% e OSHC-ve pohojnë që janë të interesuara dhe 33% deklarojnë që ndoshta në të ardhmen edhe mund të angazhohen në një aktivitet të tillë (Grafiku 16).

Grafiku 16. Keni plane për ofrimin e shërbimeve me pagesë në të ardhmen




I njëjti qëndrim (me të njëjtat përqindje përgjigjesh) vihet re dhe në interesin për krijimin e një ndërmarrje sociale (NS). 67% e organizatave të anketuara pohojnë se kanë dijeni mbi ligjin e NS por vetëm 6% e tyre kanë aplikuar sipas procedurave ligjore për të përfituar statusin e NS.

Nevojat e identifikuar nga OSHC-të në këtë kuadër janë të shumta duke filluar me ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e situatës në nivel lokal, gjenerimin e ideve novatore, dizejnimin e shërbimeve të përshatshme dhe efektive, hartimin e planeve të biznesit si dhe menaxhimin e një biznesi, rritjen e njohurive mbi kuadrin ligjor respektiv, mbështetjen me burime financiare dhe logjistike si mjedise dhe bazë materiale, shkëmbime dhe ndarje të eksperiencave të mira e shembujve të suksesit brenda sektorit. Po ashtu identifikohet si nevojë dhe ndryshimi i kuadrit ligjor për NS-të për një mjedis më mundësues për zhvillimin e tyre, promovimin, mbështetjen nëpërmjet aplikimit të skemave subvencionuese si dhe ofrimit të asistencës në ngritjen dhe gjenerimin e fondeve për një sipërmarrje të tillë.

#### Burimet e financimit dhe aksesin e OSHC-ve

Sikurse është paraqitur në Grafikon 17, aksesin në burime financimi, qofshin donatorë të huaj apo vendas, agjenci financimi, institucione shtetërore etj, në masën 79% klasifikohet mesatarisht si i vështirë (shumë i vështirë, i vështirë, disi i vështirë). Aksesin më i ulët rezultoi të jetë në AMSHC, pushtet qendror, vendor dhe tek biznesi.

Grafiku 17. Aksesi në burimet e financimit



Të dhënat e vlerësimit tregojnë se qendrueshmëria financiare e organizatave mbetet një nga shqetësimet konstante të organizatave të shoqërisë civile pavarësisht fushës ku ushtrojnë aktivitetin e tyre, viteve të eksperiencës apo vendndodhjes së tyre. 67% e OSHC-ve shprehen se nuk kanë një fond rezervë në organizatën e tyre.

Të pyetur mbi rekomandime të mundshme për rritjen e aksesit në skemat e financimit të BE-së, OSHC-të sugjerojnë:

- ✓ përafrimin e legjislacionit tatimor (zbritja/njohja e TVSH-së) sikurse në vendet fqinje mbi projektet e financuara nga programet e financimit të BE-së;
- ✓ më shumë prioritet dhe rritje të aksesit ndaj fondeve të BE-së për organizatat lokale ofruese të shërbime; aplikimi i kriterëve apo thirrjeve me karakter lokal dhe lehtësimi i procedurave për këtë kategori organizatash;
- ✓ lehtësim i procedurave raportimit;
- ✓ identifikim dhe krijimi i mundësive për mbulimin e përqindjes së kërkuar të bashkëfinancimit, sepse organizatat nuk kanë mundësi ta përballojnë.

## Nevojat e OSHC-ve për qendrueshmëri financiare

**Financimi i qendrueshëm dhe sigurimi i fondeve** afatgjatë vazhdon të mbetet nevoja bazë për pjesën më të madhe të organizatave. Burimet e financimit kryesisht ato nga fondet publike qofshin këto vendore apo qendrore konsiderohen si një prej alternativave më të qendrueshme të financimit kundrejt ekspertizës dhe shërbimeve që OSHC-të mund të ofrojnë. Nga të dhënat vihet re një orientim i nevojave të sektorit për qendrueshmëri financiare drejt **sigurimit të financimit si ofrues shërbimesh. Diversifikimi i fondeve dhe ofrimi i skemave të financimit me karakter lokal** nga donatorët e mëdhenj, duke përfshirë këtu dhe BE, është një tjetër nevojë shprehur në këtë kuadër.


Ndër të tjera nevoja të listuara nga organizatat e intervistuar veçojmë: **Rritja e kapaciteteve të stafit** në shkrim projekt propozime, ngritjen e fondeve, ofrimin e shërbimeve me pagesë dhe ngritjen e sipërmarrjeve sociale; **Shkëmbimi i eksperiencave** dhe rasteve të praktikave të mira brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në krijimin e mjedisit të favorshëm dhe ofrimin e shërbimeve me pagesë apo ngritjen e një biznesi social; dhe **Rrjetëzimi** me qëllim rritjen e mundësive të përfitimit nga thirrjet për financim kryesisht të granteve nga organizata ndërkombëtare dhe BE-së si dhe nga bashkëpunimi me sektorin privat.

## IV. PJESËMARRJA NË NISMA ADVOKUESE

Advokacia dhe pjesëmarrja në vendimmarrje, përbën një nga shtyllat kryesore të përpjekjeve të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve dhe të adresimit të nevojave të tyre pranë institucioneve qeveritare në nivel qendror e vendor. Si e tillë, zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të bërë një advokim efektiv dhe në përgjigje të nevojave të qytetarëve merr një rëndësi të veçantë.

Në kuadër të këtij vlerësimi, 79% e OSHC-ve deklarojnë që janë përfshirë në fushata advokuese në 5 vitet e fundit. Kjo përfshirje rezulton të jetë kryesisht si pjesë e iniciativave ndërmarrë nga një grupim organizatash (54% të rasteve) dhe në një përqindje më të vogël si pjesë e iniciativave ndërmarrë nga vetë organizata (42%) apo në bashkëpunim me një organizatë tjetër (29%) (Grafiku 18).


Grafiku 18. Përfshirja në fushata Advokimi



Të pyetur mbi arsyet e mundshme për mospërfshirjen në fushata advokimi (21% e organizatave që nuk janë përfshirë në fushata të tilla në 5-vjeçarin e fundit) përmendin ndër vështirësitë kryesore rrjetëzimin dhe bërjen bashkë me organizata të tjera në një fushatë advokimi si dhe mungesën e kapaciteteve financiare për iniciativa të tilla (Grafiku 19). Vlen të theksohet që 21% e OSHC-ve që nuk janë përfshirë në fushata advokimi, listojnë si arsye vështirësinë në përfshirje pasi marrin fonde nga qeveria (në nivel vendor e qendror). Ky rezultat edhe pse në një përqindje të vogël të OSHC-ve krahasimisht me totalin e OSHC-ve pjesë e studimit, ngre një shqetësim mbi lirinë e shprehjes dhe adresimin e problematikave të qytetarëve në nivel lokal dhe qendror.



Grafiku 19. Arsyet e OSHC-ve për mospërfshirje në fushata advokimi




Sa i përket çështjeve të advokimit, OSHC-të deklarojnë se janë përfshirë dhe angazhuar në një gamë të gjerë çështjesh si: të drejtat e grave dhe vajzave, barazia gjinore, lufta kundër dhunës në familje, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, rehabilitimi dhe integrimi i viktimave të trafikimit, e drejta për informim dhe pjesëmarrja në vendimmarrjen lokale, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, të drejtat e personave me aftësi të veçanta, liria e medias dhe e fjalës, strehimi, emigracioni dhe migrimi, reforma në drejtësi, reformat në arsim etj.

Përsa i përket nivelit të advokimit dhe shtrirjes gjeografike të fushatës advokuese, OSHC-të përgjithësisht deklarojnë që kanë zhvilluar fushata advokimi apo janë bërë pjesë e fushatave në nivel kombëtar dhe lokal. Në kuadër të zbatimit të projekteve rajonale dhe më gjerë në nivel Evropian, vitet e fundit, OSHC-të janë përfshirë edhe në iniciativa advokuese në këto nivele (Grafiku 20). Pavarësisht, kësaj përfshirjeje, numri i rasteve të fushatave në nivele të tilla, është jo shumë i lartë dhe më së shumti në nivel aktivitetesh e fushatash në kuadër të projekteve, e jo iniciativash të qendrueshme që ndiqen në vijimësi e që koordinohen nga platforma bashkëpunimi të OSHC-ve.

Sipas të dhënave të studimit, disa nga çështjet për të cilat është advokuar në nivel rajonal e Evropian nga OSHC-të janë të drejtat e njeriut, integrimi i komunitetit rom, të drejtat e grave dhe barazia gjinore, mbrojtja e mjedisit, krijimi i mjedisit mundësues për OSHC-të,

përmirësimi i zbatimit të legjislacionit të punës për sigurinë dhe shëndetin në punë, lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit dhe rritja e bashkëpunimit rajonal etj.

Grafiku 20. Shtrirja gjeografike e fushatave advokuese



#### Nevojat e OSHC-ve për advokim efektiv

Advokimi si një nga shtyllat kryesore të punës së organizatave të shoqërisë civile në mënyrë që të jetë sa më efektiv kërkon përpjekje e investim në kohë dhe në burime njerëzore e financiare nga OSHC-të.

Organizatave pjesë e këtij vlerësimi përtej gjetjeve të sipërpërmendura, kanë identifikuar një sërë nevojash si më poshtë vijon, në kuadër të kapacitetit advokues të tyre dhe fuqizimit të mëtejshëm në këtë drejtim.

- Mungesa e kapacitetit të OSHC-ve për ndërtimin e fushatave advokuese efektive;
- Mungesa e bashkëpunimit ndërsektorial dhe rrjetëzimit brenda dhe jashtë vendit për një impakt sa më të madh dhe të qëndrueshëm;
- Vështirësia në mobilizimin e qytetarëve për çështje me rëndësi për komunitetet lokale dhe vendin (mobilizimi mbetet në nivele të ulta);
- Niveli i ulët i vullnetarizmit dhe kuadri jofavorizues ligjor e rregullator;


- Mungesa e qendrueshmërisë financiare, çka ndikon drejtpërdrejt në mungesën e iniciativave advokuese në nivel vendor dhe qendror.
- 

## V. INTEGRIMI EVROPIAN DHE ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË KËTË PROCES

Procesi i anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe impakti i rëndësishëm që ka në zhvillimin aktual dhe të ardhshëm politiko-social-ekonomik kërkon një angazhim të të gjithë aktorëve të shoqërisë. Pavarësisht se institucionet shtetërore janë në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve ligjore përgjatë procesit të integrimit në BE, organizatat e shoqërisë civile, sipas politikave dhe programeve të BE-së, konsiderohen si një nga aktorët kyç të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces.


92% e organizatave pjesë e këtij vlerësimi e konsiderojnë shumë të rëndësishëm dhe të rëndësishëm rolin e shoqërisë civile dhe përfshirjen në procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin e Evropian (Grafiku 21).

Grafiku 21. Roli i shoqërisë civile në procesin e integrimit



Megjithë konsideratën e mësipërme për rolin e tyre dhe njohjen e rëndësisë së përfshirjes së sektorit në këtë proces, thuajse gjysma e OSHC-ve pjesë e vlerësimit deklarojnë që e njohin disi, shumë pak apo aspak procesin e integritit dhe rolin e OSHC-ve në të (Grafiku 22).

Grafiku 22. Niveli njohurive të OSHC-ve mbi procesin e integritit dhe rolin e tyre në të




Kryesisht OSHC-të e shohin rolin e shoqërisë civile në procesin e integritit më së shumti në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me këtë proces, në monitorimin e zbatimit të ligjit dhe politikave publike përgjatë procesit të negocimit dhe më pak në dhënien e ekspertizës për fusha të caktuara dhe pjesëmarrje në grupet ndërinstitucionale të punës për integritimin në BE (Grafiku 23).

Grafiku 23. Kontributi i shoqërisë civile në procesin e integritimit sipas OSHC-ve



Pavarësisht nivelit të njohurive mbi rolin e OSHC-ve apo diferencave në përkufizimin e rolit të tyre në procesin e integritimit në BE, vullneti dhe dëshira për tu përfshirë në këtë proces nëse, do t'i ofrohej një mundësi e tillë rezultojnë në masën 87% ndërkohë që 11% e organizatave të anketuara shprehin se nuk janë të sigurtë pasi nuk janë të qartë për rolin dhe kontributin që do të mund të japnin. Vetëm 2% e OSHC-ve nuk janë të interesuar për tu përfshirë aktivisht në këtë proces.

Grafiku 24. Niveli i njohjes së programeve të mbështetjes dhe financimit të BE-së nga OSHC-të



Në kuadër të integrit të vendit në Bashkimin Evropian dhe fuqizimit të shoqërisë civile, është e rëndësishme dhe identifikohet si nevojë nga OSHC-të dhe njohja më e mirë e programeve mbështetëse si të IPA, të programeve rajonale dhe të Programeve Evropiane. Vetëm 41% e OSHC-ve deklarojnë që i njohin mirë këto programe, ndërkohë të tjerat nuk kanë shumë informacion (Grafiku 24).

Programet kryesore të cilat njihen nga OSHC-të janë: IPA Bashkëpunimi Ndërkufitar, INTERREG, Ndihma për Shoqërinë Civile – Civil Society Facility (CSF), Evropa për Qytetarët, Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR), Programi Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), ACHIEVE - Shoqëri civile shqiptare Për një Mjedis Evropian në Shqipëri.


## VI. RRJETËZIMET / KOALICIONET

Kapacitetet dhe nevojat e OSHC-ve për bashkëpunim dhe grupime në koalicione e rrjete qofshin këto formale apo add hoc, marrin një rëndësi të veçantë në kuadër të amplifikimit të ndërhyrjes dhe/ose çështjes për advokim dhe rritjes së impaktit në publikun e gjerë dhe në institucionet vendimmarrëse.

Sipas të dhënave të vlerësimit rezulton se 72% e organizatave janë pjesë e një rrjeti/koalicioni, ndër të cilat 63.5% janë rrjete formale, ligjërisht të regjistruara.

Shtrirja gjeografike e veprimtarisë së rrjeteve, ku organizatat e anketuara marrin pjesë, është më së shumti kombëtare, konkretisht në 59% të rasteve, pasuar nga ai rajonal në 34% dhe Evropian në 31% të rasteve. Përfshirja e OSHC-ve të intervistuar në rrjete me shtrirje veprimi lokale mbetet më e ulët në përqindje (vetëm 25%) (Grafiku 25).

Grafiku 25. Shtrirja gjeografike e veprimtarisë së rrjeteve/koalicioneve të OSHC-ve




Prirja e OSHC-ve për t'u bërë pjesë më së shumti e rrjeteve me shtrirje të gjerë veprimtare mund të shpjegohet me interesin dhe nevojën e tyre për një impakt më të madh dhe vizibilitet më të lartë si dhe faktin që për shumë çështje si për ato lidhur me mjedisin, politikën e shërbimit social, trajtimin fiskal etj. vendimmarrja i takon institucioneve shtetërore qendrore.

Të pyetur mbi avantazhet e të qenit pjesë e një rrjeti/koalicioni, 79% e OSHC-ve e konsiderojnë pjesëmarrjen si një mundësi për të patur një impakt më të madh si dhe mbrojtje dhe përfaqësim më të mirë të interesave të grupeve që organizatat përfaqësojnë. Të qenit pjesë e rrjeteve/koalicioneve konsiderohet gjithashtu si një mundësi për më shumë sinergji dhe

shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve të njëjtja (60% të rasteve) por dhe si një faktor që lehtëson aksesin në fonde (37% të rasteve).

Nga ana tjetër, puna në rrjete e koalicione shoqërohet me shumë sfida e problematika. Në Grafikon 26 janë paraqitur disa të tilla, të identifikuara nga OSHC-të pjesë e këtij vlerësimi bazuar në punën dhe eksperiencën e tyre.

Grafiku 26. Sfidat e punës në rrjete/koalicione



Pavarësisht vështirësive e sfidave, 94% e OSHC-ve të intervistuar mbeten të gatshme të bëhen pjesë e rrjeteve dhe koalicioneve nëse do t'u ofrohej një mundësi e tillë apo nëse do të lindte nevoja.

OSHC-të janë të interesuara kryesisht të lidhen në rrjete e koalicione me organizata të tjera që kanë fokus të njëjtë veprimi dhe interesa të ngjashme. Ndër temat të cilat janë listuar nga OSHC-të e intervistuar për rrjete/koalicione potenciale janë ato mbi çështje të: mbrojtjes së të drejtave të të rinjve dhe fuqizimit ekonomik të tyre; mbrojtjes së mjedisit dhe zonave të mbrojtura; ndryshimit dhe përmirësimit të legjislacionit për OSHC-të kryesisht në krijimin e lehtësirave fiskale dhe sipërmarrjes sociale; barazisë gjinore; integritit të grupeve të marxhinalizuara dhe pakicave kombëtare, si dhe të integritit të vendit në BE.




## VII. MARRËDHËNIA ME PUSHTETIN VENDOR E QENDROR

Të dhënat e vlerësimit tregojnë se marrëdhënia e OSHC-ve me pushtetin vendor dhe atë qendror ka ende shumë nevojë për përpjekje dypalëshe, për rritjen e transparencës, besimit dhe bashkëpunimit.

52% e OSHC-ve deklarojnë se rrallë kanë bashkëpunim me institucionet e pushtetit qendror, ndërsa 27 % e tyre deklarojnë që nuk kanë fare bashkëpunim. Situata paraqitet disi më pozitive në lidhje me pushtetin vendor por gjithsesi problematike, ku 43 % e OSHC-ve deklarojnë që kanë bashkëpunim të ngushtë, 44% që kanë bashkëpunim të rrallë dhe 13% që nuk kanë fare bashkëpunim (Grafiku 27).

Bashkëpunimi me institucionet shtetërore në nivel qendror e veçanërisht në atë vendor, vazhdon të përcaktohet nga shkalla e njohjeve dhe marrëdhëniet me përfaqësuesit kryesorë të administratës dhe drejtuesit të institucionit.

Grafiku 27. Bashkëpunimi i OSHC-ve me pushtet vendor/qendror



Më shumë se gjysma e organizatave të anketuara nuk kanë dijeni të dokumentave strategjikë për bashkëpunimin OSHC-qeveri, dhe vetëm 20.2% e tyre pohojnë të kenë qenë të përfshirë në zbatimin e këtyre dokumentave.

Vetëm 47% e OSHC-ve pjesë e studimit kanë dijeni të ekzistencës së institucioneve të ngritura specifiku për bashkëpunimin midis dy sektorëve, ndër të cilat 67% e tyre kanë identifikuar Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), 16% Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), ndërsa pjesa tjetër i u është referuar mekanizmave të ngritur në

kuadër të mbrojtjes së grupeve të caktuara në nevojë apo strukturave në nivel ministrie duke nxjerrë në pah një mangësi të theksuar të njohjes së strukturave përfaqësuese të vetë sektorit nga sektori. Me të dy strukturat e identifikuar (AMSHC dhe KKSHC) bashkëpunimi klasifikohet si i munguar dhe vetë strukturat si jo funksionale dhe mbështetëse ndaj sektorit.

Të dhënat e vlerësimit tregojnë që legjislacioni i një prej mekanizmave kryesorë të përfshirjes së publikut në vendimmarrjen vendore dhe qendrore, siç është konsultimi publik, konsiderohet se njihet shumë mirë vetëm nga 19% e organizatave dhe mirë nga 28 % e tyre. Ndërkohë 37% e OSHC-ve deklarojnë se e njohin pak dhe 16% se nuk kanë dijeni për të.

Vetëm gjysma e OSHC-ve të intervistuar janë ftuar për të marrë pjesë në procese konsultimi, në nivel vendor dhe qendror (48.5%).

Takimet konsultuese, konsiderohen efektive vetëm për 55% të organizatave, rekomandimet e të cilave janë reflektuar në draft dokumentin e hedhur për konsultim. Ndërkohë për 45% të organizatave konsultimet nuk janë aspak efektive pasi rekomandimet e OSHC-ve nuk reflektohen apo merren në konsideratë, njoftimet dhe ndarja e dokumenteve për shqyrtim nuk bëhet apo bëhet vetëm disa ditë para takimit në shkelje të afateve ligjore të përcaktuara për këtë procedurë etj.

#### Nevojat e OSHC-ve për rritjen e pjesëmarrjes në proceset vendimarrëse dhe politikëbërëse

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të tyre për pjesëmarrje në proceset vendimarrëse dhe politikëbërëse, OSHC-të kanë identifikuar nevojat listuar si më poshtë vijon:


- ✓ rritja e transparencës në proceset konsultuese; përdorimi i të gjitha mjeteve të komunikimit, kryesisht ato online (web) nga ana e pushtetit vendor (bashkitë).
- ✓ përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në të gjitha fazat e politikëbërjes që nga faza fillestare deri tek ajo zbatuese dhe monitoruese;
- ✓ angazhimi në kohë i tyre dhe zbatimimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna;
- ✓ marrja në konsideratë dhe “shfrytëzimi” i ekspertizës që OSHC-të kanë në fusha të caktuara kryesisht si ofrues shërbimesh kundrejt grupeve në nevojë, nga përfaqësuesit e bashkive;
- ✓ më shumë koordinim dhe mirëzbatim i mekanizmave ekzistues të referimit/koordinimit pushtete vendor-OSHC.
- ✓ rritja e aftësive advokuese dhe lobuese të OSHC-ve, si dhe për monitorimin dhe kërkesën për llogaridhënie e transparencë të vendimmarrësve;

- ✓ rritja e njohurive dhe kapaciteteve të OSHC-ve mbi kuadrin ligjor dhe organizimin e proceseve konsultuese, politikat vendore dhe qendrore dhe nevojën e tyre për ekspertizë për një përfshirje dhe kontribut sa më efektiv;
- ✓ krijimi i një standarti të qëndrueshëm marrëdhënieje për shkëmbim eksperiencash dhe informacioni midis dy sektorëve.
- ✓ forcimi i bashkëpunimit brenda sektorit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë me rëndësi si komuniteti i biznesit.

## VIII. MARRËDHËNIA ME MEDIAN

Të dhënat e vlerësimit tregojnë se marrëdhënia e sektorit me median kryesisht në nivel kombëtar është ende larg asaj çka organizatat e shoqërisë civile dëshirojnë dhe synojnë të kenë. Sikurse paraqitet në Grafikon 28, media lokale konsiderohet si e aksesueshme për pjesën më të madhe të të anketuarve ndërkohë ajo kombëtare konsiderohet në përqindjen më të madhe si pak dhe aspak e aksesueshme.


Grafiku 28. Aksesi i OSHC-ve në media



Ky qëndrim reflektohet dhe në kanalet e komunikimit dhe mjetet e përdorura më së shumti nga organizatat për të informuar dhe ndërvepruar me publikun e gjerë ku tre më të përzgjedhurat janë: media sociale, konkretisht Facebook në 90% të rasteve, Website-i i vetë organizatës për 56.5% të organizatave si dhe media audiovizive lokale në 55% të rasteve. Ndërkohë publikimi

në revista radhitet si më pak i përdoruri nga organizatat për rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës së tyre (Grafiku 29).

Grafiku 29. Kanalet e komunikimit të OSHC-ve



Vlerësimi i marrëdhënies me median lokale dhe kombëtare, në bazë të eksperiencave të organizatave të anketuara është i ndryshëm dhe i polarizuar. 49% e organizatave të përgjigjura e vlerësojnë marrëdhënien me median si “të mirë dhe disi të mirë”, “korrekte” dhe “pozitive”, 15% si “shumë të mirë” pa cilësuar llojin e medias. Ndërkohë 12% e organizatave në vlerësimin e tyre e ndajnë sipas llojit të medias ku marrëdhënia me median lokale cilësohet si e mirë dhe e aksesueshme, ndërsa media kombëtare klasifikohet si pak e aksesueshme dhe e largët.

Nga një pjesë e konsiderueshme e organizatave marrëdhënia cilësohet si e dobët, jobashkëpunuese dhe e vështirë. Disa OSHC e etiketojnë median si të orientuar drejt fitimit duke shfaqur interes dhe bashkëpunim vetëm në rastet kundrejt pagesave.

Duke e konsideruar këtë marrëdhënie si shumë të rëndësishme jo vetëm në rritjen e vizibilitetit të punës së shoqërisë civile por kryesisht në rritjen së e impaktit dhe ndërgjegjësimit në publikun e gjerë dhe aktorëve të tjerë në rolin që shoqëria civile luan në demokratizimin e shoqërisë, media duhet vlerësuar si partner e aktor i rëndësishëm.

Në këtë kuadër për përmirësimin e marrëdhënies midis dy sektorëve, OSHC-të identifikojnë aktivitetet si më poshtë vijon:

- ✓ krijimi i partneritetit nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve me interes për të dyja palët apo projekteve të tilla
- ✓ organizimi i forumeve të diskutimit midis dy sektorëve me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të medias për punën dhe kontributin e OSHC-ve.
- ✓ takime periodike midis dy sektorëve me qëllim gjetjen e hapësirave të bashkëpunimit dypalësh.
- ✓ ngritja e kauzave në mënyrë të drejtë dhe përfshirja e sa më shumë aktorëve sidomos atyre të ndikuar në mënyrë direkte; mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me mediat dhe ushqimi me informacion të qartë e të besueshëm.
- ✓ aplikimi i subvencioneve shtetërore mbi tarifatat e kërkuara nga media në lidhje me aktivitetin e sektorit.
- ✓ më shumë aktivitete për rritjen e përgjegjshmërisë sociale të medias.

## IX. MARRËDHËNIA ME SEKTORIN PRIVAT

Sektori privat çdo ditë e më shumë po merr një rëndësi të veçantë jo vetëm si një prej burimeve të financimit dhe mbështetjes për aktivitetin e OSHC-ve por si një partner i mundshëm në zhvillimin e modeleve dhe ofertës për shërbimet me pagesë të ofruara nga OSHC-të, duke u kthyer kështu në një faktor të rëndësishëm për qendrueshmërinë e organizatave.


Megjithatë, marrëdhënia midis sektorit privat dhe atij të shoqërisë civile, bazuar në të dhënat e vlerësimit, rezulton të jetë ende e pazhvilluar. Sikurse u përmend dhe më lart, aksesimi që OSHC-të kanë tek biznesi është i ulët. Shumica e OSHC-ve (67%) deklarojnë që nuk kanë patur bashkëpunime me sektorin privat dhe as kanë marrë fonde nga ky sektor.

Në rastet kur ky bashkëpunim ka ekzistuar ai ka qënë në formë organizimi aktivitetesh të përbashkëta ku kontributi i biznesit ka qënë përgjithësisht “in kind” (28%) dhe me fonde (31%).

Sipas të dhënave të vlerësimit rezulton se përpjekja e sektorit të biznesit për t’u njohur dhe bashkëpunuar me organizatat jofitimprurëse është në nivele shumë të ulta. Kështu vetëm në 2% të rasteve, OSHC-të deklarojnë që ka qënë biznesi i interesuar për ti takuar e njohur punën e tyre, ndërkohë në 60% të rasteve kërkesat për takim e bashkëpunim janë iniciuar nga organizatat.

Pavarësisht nëse kanë patur apo jo bashkëpunime të mëparshme, 80% e OShC-ve shprehen se sektori i biznesit është i njohur dhe ka dijeni rreth punës së organizatës së tyre. Kryesisht kjo njohuri është marrë gjatë takimeve dhe eventeve të organizuar nga OSHC-të dhe organizata partnere që lehtësojnë krijimin e marrëdhënieve midis sektorëve si dhe nga njësitë e vet-qeverisjes vendore (Grafiku 30).

Grafiku 30. Si njihet biznesi me OSHC-të dhe veprimtarinë e tyre



Nevojat për rritje të kapaciteteve për zhvillimin e bashkëpunimit me sektorin e biznesit  
 Nevojat kryesore të identifikuara nga OSHC-të për rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me sektorin privat janë:

- ✓ trajnime në njohjen e legjislacionit dhe lehtësirave/mekanismave ekzistues fiskal, lidhur me mbështetjes financiare nga biznesi për oshc-të;
- ✓ njohja dhe ndarja e eksperiencave dhe modeleve të sukseshme të bashkëpunimit oshc-biznes në vend;
- ✓ njohja me sektori e biznesit për ngritjen e partneritetit me të (takime dhe aktivitete njohëse);
- ✓ vlerësim i nevojave të biznesit mbi shërbimet e ofruara nga oshc-të, krijimi i platformave të përbashkëta për plotësimin e nevojave reciproke;
- ✓ zhvillimi i filantropisë;

- ✓ bashkëpunim në fushtata advokacie drejtuar pushtetit lokal; organizim i tryezave ndërsektoriale për më shumë punësim të grupeve në nevojë pranë biznesit.

## KONKLUSIONE

Bazuar në gjetjet e vlerësimit të kapacitetit të OSHC-ve dhe nevojave të tyre, ky seksion përmbledh përfundimet e vlerësimit dhe nevojat për ndërhyrje të mëtejshme me qëllim adresimin e problematikave të identifikuara.

### Zhvillimi institucional dhe qendrueshmëria organizative

- ✓ **Politikat e procedurat e brendshme organizative.** Më shumë se gjysma e OSHC-ve të përfshira në vlerësim deklarojnë që kanë politika dhe procedura bazë të brendshme organizative, miratuar nga organet vendimmarrëse, të cilat rregullojnë veprimtarinë e organizatës. Gjithsesi mbetet ende një pjesë e konsiderueshme që nuk kanë procedura të tilla dhe që duan ti zhvillojnë.
- ✓ **Plani Strategjik.** Vetëm 58% e organizatave kanë një plan strategjik. Planifikimi strategjik është një faktor kyç për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile dhe qendrueshmërinë e tyre. Ai është shumë i rëndësishëm por në të njëjtën kohë mund të jetë diçka shumë komplekse dhe e vështirë për t'u realizuar veçanërisht nga organizatat e vogla e pa shumë kapacitete. Pjesa e OSHC-ve që nuk kanë një plan të tillë, shprehin qartë nevojën për udhëzim dhe mbështetje për hartimin e tij. Ndërkohë kjo nevojë deklarohet dhe nga OSHC që e kanë planin strategjik, duke qenë se është një dokument bazë për zhvillimin e organizatës dhe nevojitet të rishikohet dhe zhvillohet periodikisht.
- ✓ **Sfida dhe nevoja në zhvillimin dhe qendrueshmërinë organizative të OSHC-ve.** Çështjet më sfiduese për organizatat dhe veprimtarinë e tyre, sipas deklaramit të OSHC-ve mbeten: (1) Mungesa e fondeve (2) Kuadri ligjor dhe fiskal për OSHC-të (3) Mungesa e bashkëpunimit me pushtetin vendor e qendror dhe mospërfshirja në politikëbërje dhe (4) Mungesa e mekanizmave/pamundësia për të marrë pjesë në tendera për ofrimin e shërbimeve publike. Për adresimin e këtyre nevojave nevojitet një ndërhyrje shumëplanëshe në: rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të sektorit në lidhje me këto çështje (ngritjen e fondeve, gjenerimin e të ardhurave, kuadrin ligjor dhe fiskal, pjesëmarrjen në politikëbërje, ofrimin e shërbimeve); rritjen e bashkëpunimit me pushtetin vendor e qendror; rritjen e bashkëpunimit me biznesin; advokimin për krijimin e mekanizmave dhe incentivave për OSHC-të.
- ✓ **Nevojat për trajnim.** Megjithë zhvillimin e sektorit në vite dhe krijimit të një eksperience të gjatë, nevoja për rritje kapacitetesh mbetet e madhe. Nevojat më të mëdha për trajnim të stafit drejtues të OSHC-ve janë për ngritjen e fondeve dhe gjenerimin e të ardhurave, planifikimi strategjik, sipërmarrja sociale, ndërtimi i rrjeteve / koalicioneve dhe legjislacioni tatimor e raportimi financiar. Ndërkaq, për stafin e

OSHC-ve nevojat kryesore për trajnim rezultojnë në tema si: programet e mbështetjes dhe financimit të BE, shkrimi i projekt propozimeve sipas kërkesave dhe formateve të Bashkimit Evropian si dhe zhvillimi i projekt propozimeve në përgjithësi, ngritja e fondeve e gjenerimi i të ardhurave si dhe manaxhimi i projekteve.

- ✓ **Partneriteti dhe Rrjetëzimet.** Mungesa e partneritet dhe rrjetëzimit midis organizatave në vend dhe jashtë tij, rezulton si një tjetër nevojë në sektor. Partneriteti kryesisht shihet nga OSHC-të në kuadër të aplikimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkëta brenda organizatave me mision e fushë të ngjashme veprimi, si dhe për përfitimin e njohurive dhe eksperiencave nga organizata më të zhvilluara, me më shumë kapacitete dhe të përqëndruara kryesisht në zonat urbane (veçanërisht në Tiranë). Mungesa e aktiviteteve dhe mbështetjes për rrjetëzime e partneritete; numri i limituar i programeve të shkëmbimit të eksperiencave, modeleve e praktikave të mira; i vizitave studimore që mundësojnë avancimin e mëtejshëm të OSHC-ve etj. janë disa nga nevojat e identifikuar nga OSHC-të. Aksesit dhe pjesëmarrja e ulët në rrjete rajonale dhe Evropiane është një nevojë që mbetet po ashtu për tu adresuar, me qëllim fuqizimin institucional, rritjen e vizibilitetit dhe marrëdhënies me publikun dhe aktorë të tjerë, si dhe përthithjen e fondeve.
- ✓ **Raportimi dhe transparenca e OSHC-ve.** Transparenca në sektor mbetet një çështje për të cilën nevojitet të punohet nga i gjithë sektori me qëllim përmirësimin e mëtejshëm. Ajo ndikon drejtpërsëdrejti edhe në krijimin e besimit dhe partneritetit me aktorë të tjerë (qeverinë, biznesin, median) si dhe antarët/përfituesit e shërbimeve të tyre, e për rrjedhojë edhe në zhvillimin dhe qendrueshmërinë organizative, Vetëm 58% e organizatave i publikojnë dhe i ndajnë raportet vjetore nëpërmjet kanaleve të tyre të komunikimit brenda sektorit, grupeve të interesit dhe më gjerë. Mbetet e domosdoshme rritja e ndërgjegjësimit dhe puna brenda sektorit për adresimin e kësaj çështjeje me qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së sektorit.

#### Menaxhimi dhe qendrueshmëria financiare

- ✓ **Burimet e financimit dhe aksesit i OSHC-ve.** Aksesit në burime financimi, qofshin donatorë të huaj apo vendas, agjenci financimi, institucione shtetërore etj. në masën 79% klasifikohet si i vështirë. Aksesit më i ulët rezulton të jetë në AMSHC, pushtet qendror, vendor dhe tek biznesi. Të dhënat e vlerësimit tregojnë se qendrueshmëria financiare e organizatave mbetet një nga shqetësimet konstante të organizatave të shoqërisë civile pavarësisht fushës ku ushtrojnë aktivitetin e tyre, viteve të eksperiencës apo vendndodhjes së tyre.
- ✓ **OSHC-të si ofruer të shërbimeve me pagesë.** Ofrimi i shërbimeve me pagesë nga OSHC-të për palë të treta vitet e fundit po përdoret gjithnjë e më shumë nga sektori i shoqërisë civile si një nga format për ngritjen dhe gjenerimin e fondeve. 32% e OSHC-ve pjesë e vlerësimit kanë eksperiencë të tilla. Ndër shërbimet e ofruara përmenden kurse trajnimi dhe ofrimi i ekspertizës brenda sektorit por dhe jashtë tij, prodhime artizanale, shërbime bar kafe dhe catering, guida turistike, shërbime mjekësore dhe shërbime sociale. Një tjetër formë gjenerimi të ardhurash është dhënia me qira e



mjediseve të organizatës për palë të treta si dhe ngritja e sipërmarrjeve sociale. Shpërndarja gjeografike e organizatave që ofrojnë këto shërbime shtrihet në të tre rajonet por përqëndrimi më i madh mbetet në qytetin e Tiranës (40%). Ky model konsiderohet si i paeksploruara nga qytetet e tjera të vendit, duhet promovuar më tej e duhen rritur kapacitetet jashtë Tirane për këtë çështje. OSHC-të që nuk kanë ndërmarrë ende iniciativa në këtë drejtim, janë të interesuara por e konsiderojnë procesin si të vështirë dhe sfidues dhe u mungojnë njohuritë dhe kapacitetet e duhura për të zhvilluar dhe menaxhuar një aktivitet të tillë. Në këtë drejtim nevojitet adresimi i këtyre nevojave me programe trajnimi dhe asistence.

### Pjesëmarrja e OSHC-ve në nisma advokuese

- ✓ **Përfshirja në advokim.** Përfshirja e OSHC-ve në advokim rezulton të jetë kryesisht si pjesë e iniciativave ndërmarrë nga një grupim organizatash ose si pjesë e iniciativave ndërmarrë nga vetë organizata. 79% e OSHC-ve deklarojnë që janë përfshirë në fushata advokuese në 5 vitet e fundit. Përsa i përket nivelit të advokimit dhe shtrirjes gjeografike të fushatës advokuese, OSHC-të përgjithësisht deklarojnë që kanë zhvilluar fushata advokimi apo janë bërë pjesë e fushatave në nivel kombëtar dhe lokal. Pavarësisht, kësaj përfshirjeje, numri i rasteve të fushatave në nivele të tilla, është jo shumë i lartë dhe më së shumti në nivel aktivitetesh e fushatash në kuadër të projekteve, e jo iniciativash të qendrueshme që ndiqen në vijimësi e që koordinohen nga platforma bashkëpunimi të OSHC-ve.
- ✓ **Pengesat për përfshirje në advokim.** Ndër pengesat kryesore identifikohen vështirësia për rrjetëzime dhe bërjen bashkë me organizata të tjera; mungesa e kapaciteteve financiare për iniciativa të tilla; dhe fakti që OSHC-të marrin fonde nga qeveria (në nivel vendor e qendror).
- ✓ **Nevojat e OSHC-ve për advokim efektiv.** Advokimi si një nga shtyllat kryesore të punës së organizatave të shoqërisë civile në mënyrë që të jetë sa më efektiv kërkon përpjekje e investim në kohë dhe në burime njerëzore e financiare nga OSHC-të. OSHC-të identifikojnë një sërë nevojash në kuadër të kapacitetit advokues të tyre dhe fuqizimit të mëtejshëm në këtë drejtim si: mungesa e kapacitetit për ndërtimin e fushatave advokuese efektive; mungesa e bashkëpunimit ndërsektorial dhe rrjetëzimit brenda dhe jashtë vendit për një impakt sa më të madh dhe të qendrueshëm; vështirësia në mobilizimin e qytetarëve për çështje me rëndësi për komunitetet lokale dhe vendin (mobilizimi mbetet në nivele të ulta); niveli i ulët i vullnetarizmit dhe kuadri jofavorizues ligjor e rregullator; mungesa e qendrueshmërisë financiare, çka ndikon drejtpërdrejt në mungesën e iniciativave advokuese në nivel vendor dhe qendror.

### Integrimi evropian dhe roli i shoqërisë civile në këtë proces

- ✓ Procesi i anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe impakti i rëndësishëm që ka në zhvillimin aktual dhe të ardhshëm politiko-social-ekonomik kërkon një angazhim

të të gjithë aktorëve të shoqërisë. Pavarësisht se institucionet shtetërore janë në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve ligjore përgjatë procesit të integrimit në BE, organizatat e shoqërisë civile, sipas politikave dhe programeve të BE-së, konsiderohen si një nga aktorët kyç të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces. 92% e OSHC-ve e konsiderojnë shumë të rëndësishëm dhe të rëndësishëm rolin e shoqërisë civile dhe përfshirjen në procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin e Evropian.

- ✓ OSHC-të kryesisht e shohin rolin e shoqërisë civile në procesin e integrimit më së shumti në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me këtë proces, në monitorimin e zbatimit të ligjit dhe politikave publike përgjatë procesit të negociimit dhe më pak në dhënien e ekspertizës për fusha të caktuara dhe pjesëmarrje në grupet ndërinstucionale të punës për integrimin në BE.
- ✓ Vetëm gjysma e OSHC-ve pjesë e vlerësimit kanë disa njohuri për procesin e integrimit dhe rolin e OSHC-ve në të. Rritja e njohurive në këtë drejtim, identifikohet si nevojë kryesore për OSHC-të me qëllim që të mund të luajnë rol aktiv gjatë procesit të negociimit.
- ✓ Më pak se gjysma e OSHC-ve kanë njohuri për programet mbështetëse të BE-së si IPA, të programeve rajonale dhe të Programeve Evropiane. Rritja e kapaciteteve përmes sesioneve informuese dhe programeve të trajnimit e asistencës edhe në këtë drejtim mbetet e madhe.

#### Rrjetëzimet / koalicionet

- ✓ OSHC-të janë pjesë e rrjeteve/kolicioneve më së shumti në nivel kombëtar, rajonal dhe Evropian. Përfshirja e OSHC-ve në rrjete me shtrirje veprimi lokale mbetet më e ulët.
- ✓ OSHC-të janë të interesuara kryesisht të lidhen në rrjete e koalicione me organizata të tjera që kanë fokus të njëjtë veprimi dhe interesa të ngjashme.
- ✓ Ndër temat të cilat janë listuar nga OSHC-të e intervistuar për rrjete/koalicione potenciale janë ato mbi çështje të: mbrojtjes së të drejtave të të rinjve dhe fuqizimit ekonomik të tyre; mbrojtjes së mjedisit dhe zonave të mbrojtura; ndryshimit dhe përmirësimit të legjislacionit për OSHC-të kryesisht në krijimin e lehtësirave fiskale dhe sipërmarrjes sociale; barazisë gjinore; integrimit të grupeve të marxhinalizuara dhe pakicave kombëtare, si dhe të integrimit të vendit në BE.
- ✓ Puna në rrjete dhe koalicione, paraqet shumë sfida e vështirësi ku kryesoret mbeten mungesa e fondeve për aktivitetin e rrjetit/koalicionit dhe kapacitetet e ulta të burimeve njerëzore. Pavarësisht vështirësive e sfidave, 94% e OSHC-ve të intervistuar mbeten të gatshme të bëhen pjesë e rrjeteve dhe koalicioneve nëse do t'u ofrohej një mundësi e tillë apo nëse do të lindte nevoja.

#### Marrëdhënia me pushtetin vendor e qendror

- ✓ Të dhënat e vlerësimit tregojnë se marrëdhënia e OSHC-ve me pushtetin vendor dhe atë qendror ka ende shumë nevojë për përpjekje dypalëshe, për rritjen e transparencës,

- besimit dhe bashkëpunimit. 52% e OSHC-ve deklarojnë se rrallë kanë bashkëpunim me institucionet e pushtetit qendror, ndërsa 27 % e tyre deklarojnë që nuk kanë fare bashkëpunim. Në lidhje me pushtetin vendor 44% e OSHC-ve kanë bashkëpunim të rrallë dhe 13% nuk kanë. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore në nivel qendror e veçanërisht në atë vendor, vazhdon të përcaktohet nga shkalla e njohjeve dhe marrëdhëniet me përfaqësuesit kryesorë të administratës dhe drejtuesit të institucionit.
- ✓ Më shumë se gjysma e organizatave të anketuara nuk kanë dijeni të dokumentave strategjikë për bashkëpunimin OSHC-qeveri.
  - ✓ Vetëm 47% e OSHC-ve pjesë e studimit kanë dijeni të ekzistencës së institucioneve të ngritura specifikisht për bashkëpunimin midis dy sektorëve, ndër të cilat 67% e tyre kanë identifikuar Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), 16% Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC). Bashkëpunimi me AMSHC dhe KKSHC bashkëpunimi klasifikohet si i munguar dhe strukturat konsiderohen si jo funksionale dhe mbështetëse për sektorin.
  - ✓ Legjislacioni për konsultimin publik, në një masë të madhe nuk njihet nga OSHC-të. Pjesëmarrja në procese konsultimi, në nivel vendor dhe qendror mbetet e ulët. Edhe në rastet kur ka konsultime, nuk konsiderohen efektive pasi rekomandimet e OSHC-ve nuk reflektohen apo merren në konsideratë, njoftimet dhe ndarja e dokumenteve për shqyrtim nuk bëhet apo bëhet vetëm disa ditë para takimit në shkëlje të afateve ligjore të përcaktuara për këtë procedurë etj.
  - ✓ Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në proceset vendimarrëse dhe politikëbërëse nevojitet: përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në të gjitha fazat e politikëbërjes që nga faza fillestare deri tek ajo zbatuese dhe monitoruese; angazhimi në kohë i tyre dhe zbatimimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna; rritja e aftësive advokuese dhe lobuese të OSHC-ve, si dhe për monitorimin dhe kërkesën për llogaridhënie e transparencë të vendimmarrësve; rritja e njohurive dhe kapaciteteve të OSHC-ve mbi kuadrin ligjor dhe organizimin e proceseve konsultuese, politikat vendore dhe qendrore dhe nevojën e tyre për ekspertizë për një përfshirje dhe kontribut sa më efektiv; forcimi i bashkëpunimit brenda sektorit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë me rëndësi si komuniteti i biznesit.

#### Marrëdhënia me median

- ✓ Marrëdhënia e sektorit me median kryesisht në nivel kombëtar është ende larg asaj çka organizatat e shoqërisë civile dëshirojnë dhe synojnë të kenë. Media lokale konsiderohet si e aksesueshme për pjesën më të madhe të të anketuarve ndërkohë ajo kombëtare konsiderohet në përqindjen më të madhe si pak dhe aspak e aksesueshme.
- ✓ Kanalet e komunikimit më të përdorura nga organizatat për të informuar dhe ndërvepruar me publikun e gjerë janë: media sociale (kryesisht Facebook), Website-i i OSHCsë dhe media audiovizive lokale.
- ✓ Marrëdhënia me median konsiderohet si shumë të rëndësishme jo vetëm në rritjen e vizibilitetit të punës së shoqërisë civile por kryesisht në rritjen së e impaktit dhe

ndërgjegjësimin në publikun e gjerë dhe aktorëve të tjerë në rolin që shoqëria civile luan në demokratizimin e shoqërisë.

- ✓ Për përmirësimin e marrëdhënies midis dy sektorëve, nevojitet rritja e shkëmbimit të informacionit mes sektorëve; rritja e kapaciteteve të OSHC-ve në lidhje me komunikimin dhe punën me median; krijimi i partneritetit nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve/projekteve të përbashkëta; organizimi i forumeve të përbashkëta të diskutimit me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin dhe sesnsibilizimit të medias për punën dhe kontributin e OSHC-ve, etj.

#### Marrëdhënia me sektorin privat

- ✓ Marrëdhënia midis sektorit privat dhe atij të shoqërisë civile është ende e pazhvilluar. OSHC-të kanë pak akses tek biznesi. Shumica e OSHC-ve deklarojnë që nuk kanë patur bashkëpunime me sektorin privat dhe as kanë marrë fonde nga ky sektor.
- ✓ Sektori privat çdo ditë e më shumë po merr një rëndësi të veçantë jo vetëm si një prej burimeve të financimit dhe mbështetjes për aktivitetin e OSHC-ve por si një partner i mundshëm në zhvillimin e modeleve dhe ofertës për shërbimet me pagesë të ofruara nga OSHC-të, duke u kthyer kështu në një faktor të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e organizatave.
- ✓ Nevojat kryesore të identifikuar nga OSHC-të për rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me sektorin privat janë: rritje e njohurive të OSHC-ve në njohjen e legjislacionit dhe lehtësirave/mekanizmave ekzistues fiskal, lidhur me mbështetjes financiare nga biznesi për OSHC-të; krijimi i mundësive për njohjen mes sektorëve dhe zhvillimit të partneritet; njohje dhe shkëmbim eksperiencash i modeleve të sukseshme të bashkëpunimit OSHC-biznes në vend; dhe zhvillimi i një kuadri ligjor e rregullator mundësues për zhvillimin e filantropisë.

## REFERENCA

- Humans Rights Watch Report 1999 gjetur në <https://www.hrw.org/legacy/worldreport99/>
- Progres Raporti për Shqipërinë, 2012, Komisioni Evropian, gjetur në [https://www.parlament.al/Files/Integrimi/2012\\_progress\\_report\\_en\\_23392\\_1.pdf](https://www.parlament.al/Files/Integrimi/2012_progress_report_en_23392_1.pdf)
- Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë, 2018, gjetur në [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Matrica\\_monitorimit\\_Raporti\\_per\\_shqiperine\\_2018.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Matrica_monitorimit_Raporti_per_shqiperine_2018.pdf)

- Migracioni në Shqipëri, Instat 2014, gjetur në [http://www.instat.gov.al/media/3078/migracioni\\_ne\\_shqiperi.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3078/migracioni_ne_shqiperi.pdf)
- Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2019, Instat <http://www.instat.gov.al/media/5956/burrat-dhe-grat%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2019.pdf>
- Analizë e Kuadrit Ligjor mbi Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri, Partnerët Shqipëri, 2019 gjetur në [http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/06/Analiz%C3%AB\\_e\\_Kuadrit\\_Ligjor\\_mbi\\_Nd%C3%ABrmar\\_rjet\\_Sociale\\_n%C3%AB\\_Shqip%C3%ABri.pdf](http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/06/Analiz%C3%AB_e_Kuadrit_Ligjor_mbi_Nd%C3%ABrmar_rjet_Sociale_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri.pdf)
- Platformat croëdfunding – Një burim alternativ i financimit, Partnerët Shqipëri, 2019, gjetur në <http://partnersalbania.org/publication/platformat-croëdfunding-nje-burim-alternativ-i-financimit/>
- Gatishmëria e OSHC-ve për Përfshirjen në Aktivitete që Gjenerojnë të Ardhura, Partnerët Shqipëri, 2018 gjetur në [https://partnersalbania.org/ëp-content/uploads/2018/09/Gatishmeria\\_OSHCve\\_per\\_Perfshirje\\_ne\\_Aktivitete\\_qe\\_Gj\\_enerojne\\_te\\_Ardhura.pdf](https://partnersalbania.org/ëp-content/uploads/2018/09/Gatishmeria_OSHCve_per_Perfshirje_ne_Aktivitete_qe_Gj_enerojne_te_Ardhura.pdf)